



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/24/22
Datë: 27.09.2022 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 21 paragrafi 21.1 pika h) të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 27.09.2022 nxjerrë:

V E N D I M

për fillimin e procedurave për plotësim ndryshimin e projekt Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa

- I. Me këtë vendim fillohet hartimi i (projekt) i Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa, në tekstin e më poshtëm / (projekt) Rregullorja/.
- II. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të kësaj (projekt) rregullorje, sipas këtij vendimi është krijimi i bazës ligjore për fillimin e hartimit të projekt Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa .
- III. Bartëse e hartimit të (projekt) Rregullores nga pika I. e këtij vendimi është Zyra e Kryetarit të Komunës së Junikut dhe Drejtoria për Financa .
- IV. Bartësja e hartimit të (projekt) rregullores është e obliguar që (projekt) Rregulloren ta hartojë në afat prej 2 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- V. Obligohet Kuvendi i Komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të emëroj Grupin e punës për hartimin e (projekt) rregullores nga pika I. e këtij vendimi.
- VI. (Projekt) rregullorja duhet të vihet në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e (projekt) Rregullores në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.
- VII. Pas hartimit, (projekt) Rregullorjai procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.
- VIII. Mjetet financiare për hartimin e (projekt) Rregullores sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.
- IX. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

X. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Financa e Komunës së Junikut.

XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut.



Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 297
<http://rks-gov.net/junik>